



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:039450
Datë: 05.09.2024
Numri i dokumentit: 06124504

C.nr.454/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, duke vendosur në çështjen juridike-civile të paditësit A. S. G. nr. personal ... nga P., të cilin e përfaqëson i autorizuari avokatura “K. & A.” me avokatët e saj S. K. etj., nga P., U. C..., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga P., Rruga “N. G.” pn., baza e kontestit: Kompensimin e shujtave të ushqimit ditor, me vlerë kontesti prej: 408.00 Euro, jashtë seancës me datë 05.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË padia dhe kërkesëpadia e paditësit A. S. G., nga P., kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria për Arsim nga P., Rruga “N. G.” pn., për kompensim e shujtave të ushqimit ditor, **si e PALEJUESHME**.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstaton se paditësit kompensimin e shujtave të ushqimit ditor, i ka realizuar gjegjësisht është vendosur në procedurën kontestimore, ndaj të paditurës dhe se ndaj kësaj të paditure, paditësi nuk ka kërkesa tjera lidhur me këtë objekt kontestimor. Ashtu që lidhur me këtë çështje juridike sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në P. C.nr. ... (...) të dt.02.08.2023, i cili është i formës së prerë nga data 12.10.2023, paditësi ka bërë realizim të kërkesave-është vendosur lidhur me çështjen e iniciuar me padi në këtë rast, dhe tani kjo çështje është jolëndore çështje e gjykuar (res judicata).

Andaj, Gjykata në bazë të gjithë këtyre provave të ofruara në padi dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare se çështja e ngritur me padi është çështje e gjykuar, erdhi në përfundim se çështja kontestuese e ngritur me padinë respektivisht kërkesa e paditësit është çështje e gjykuar dhe si e tillë kjo çështje juridike, tani është jolëndore (res judicata) çështje e gjykuar dhe në bazë të dispozitave të nenit 391.1 pika d), si dhe bazuar në nenin 166.2 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në të cilin nen thuhet se: “Gjykata gjatë gjithë

procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është e gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura e iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.”.

Me nenin 391.1 pika d) të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), ku është paraparë se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata);”.*

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 391.1 pika d) të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), e hodhi poshtë padinë si të palejueshme.

Vendimi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore u more në kuptim të dispozitave të nenit 450 të LPK-së.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i përgjithshëm
C.nr.454/2023 të datës 05.09.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesë, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, e nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.